



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 238 / Prot.
12

Tiranë, më: 7/10/2025

URDHËR

Nr. 20, Datë 7.10.2025

**“PËR
NGRITJEN E AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR PARANDALIMIN E
KONFLIKTIT TE INTERESAVE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “b”, pika 2, e nenit 41 dhe pika 3, e nenit 42, të ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 25.9.2025 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave, në Ministrinë e Mjedisit.
2. Caktimi i anëtarëve të Autoritetit Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të intresave:
 - **Znj. Inxhi Buzi**, Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse;
 - **Znj. Dorina Hoxha**, Specialist i burimeve njerëzore, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit;
 - **Znj. Erinda Fejzulla**, Përgjegjës i Sektorit të Këshillimit Ligjor dhe Monitorimit të Impaktit të Akteve Rregullatore.
3. Autoriteti Përgjegjës të mbajë në vijimësi kontaktet me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe të Konfliktit të Interesave.
4. Urdhri i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, nr. 85, datë 24.2.2025 “Për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit”, shfuqizohet.
5. Ky Urdhër t’i njoftohet zyrtarisht ILDKPKI-së.
6. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Autoriteti Përgjegjës në Ministrinë e Mjedisit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR

Sofjan JAUPAJ